



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 100 datë 30-10-2025

**PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
SË DATËS 30 TETOR 2025 TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË**

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi shqyrtoi me këshilltarët dhe miratoi propozimet e paraqitura si dhe pikat e rendit të ditës të njoftuara për vendimarrje në njoftimin për mbledhjen e datës 21.8.2025, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 5 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 55 pika 3, pika 4 shkronja (a) e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr.80, datë 30.07.2020.

VENDOSI;

1. Të miratojë rendin e ditës për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Korçë sipas njoftimit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 32 vota

Vota Pro 32

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 30-10-2025

KRYETARE

Ana VERUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

Korçë më 23.10.2025

Lënda: Njoftim

Drejtuar: Këshilltarëve të Këshillit Bashkiak Korçë

Kryetarit të Bashkisë Korçë **z.Sotiraq Filo**

Njoftohen të gjithë këshilltarët e Këshillit Bashkiak Korçë dhe Kryetari i Bashkisë Korçë z.Sotiraq Filo, se ditën **e enjte, datë 30 tetor 2025, ora 12⁰⁰** do të zhvillohet mbledhja e Këshillit në sallën e Këshillit Bashkiak, në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53,pika 4 si dhe bazuar në Rregulloren e Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr.80, datë 30.07.2020 , neni 63, neni 64 me rend dite si më poshtë:

- 1- "PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS".
- 2- "MBI VËRTETIMIN E MANDATEVE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT ZNJ.MIRELA QELESHI DHE Z.SANJEL SKËNDERAS".

(Komisioni i verifikimit të mandateve) , z.Emiljano Muharem, znj.Jorida Romaçka, z.Llambert Malaveci.

- 3- "PËR CAKTIMIN E KËSHILLTARËVE ZNJ.MIRELA QELESHI DHE Z.SANJEL SKËNDERAS NË KOMISIONET E PËRHERSHME TË KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË".

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë) z. Erjon Nexhipi, znj.Edlira Mitre, z.Erjon Kurti, z.Kristiano Koçibelli.

4- "PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 25 SHTATOR 2025".

5- "MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6 % E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR PËR PERIUDHËN 1-30 SHTATOR 2025".

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj.Anxhela Taho , znj.Edlira Mitre , znj.Ornela Alikaj, z.Erjon Kurti, znj.Jorida Romaçka, z.Lorenc Nako, znj.Laureta Alidinaj.

6- "PËR MIRATIMIN E RRITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË FINANCUAR NGA KËSHILLI I QARKUT KORÇË NË VLERËN 150.000 LEKË PËR QËNDRËN REZIDENCIALE TË ZHVILLIMIT".

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare) z.Altin Habip, znj.Ada Përmeti, z.Petrika Tollkuçi, z.Devis Osmani znj.Alketa Zheku.

7- "PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR 8, DATË 30.01.2025 "PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL PËR INSTITUCIONIN E BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2025".

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë) z. Erjon Nexhipi, znj.Edlira Mitre, z.Erjon Kurti, z.Kristiano Koçibelli.

8- "PËR MIRATIMIN E VENDOSJES TË NJË MONUMENTI PËRKUJTIMOR NË FSHATIN VOSKOPOJË".

(Komisioni i Zhvillimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) z.Erjon Nexhipi, z.Altin Habip, znj.Majlinda Duni, z.Irvin Bode, znj. Laureta Alidinaj.

(Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturore dhe Emërtimeve) znj.Paola Kodra, z.Pandi Bello, z.Erjols Haxhillari, znj.Suela Dinellari, z.Lazjon Petri.

9- "PËR VAZHDIMIN E PROCEDURËS TË ZGJEDHJES TË KRYETARIT TË FSHATIT VITHKUQ, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE VITHKUQ".

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë) z. Erjon Nexhipi, znj.Edlira Mitre, z.Erjon Kurti, z.Kristiano Koçibelli.

10-RAPORTI I MONITORIMIT JANAR-GUSHT 2025.

11-PIKA TË NDRYSHME.

12-KËRKESA-ANKESA TË QYTETARËVE.

Mbledhjet e komisioneve do të zhvillohen ditën e hënë , datë 27.10.2025, ora 11⁰⁰

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare) z. Altin Habip, znj. Ada Përmeti
z. Petrika Tollkuçi, z. Devis Osman, znj. Alketa Zheku ditën e hënë 27.10.2025, ora 12⁰⁰

Komisionet do të zhvillojnë mbledhjet në sallën e Këshillit Bashkiak.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Ana VERUSHI

